

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8JH-1
SH35

QAZIM SHEMAJ

poezi



DAULJA
E FESTIVALIT

8JH-1
SH 35

QAZIM SHEMAJ

Dauillja e Festivalit

p o e z i



SHTËPIA BOTUESE - NAIM FRASHËRI

BUKURIA

E bukur,
ti s'je vetém kaq: «Një lule Sopot»,
ti s'je thjesht: «Petale të mëdha»...
për ty më tregoi kënga e një rapsodi:
«Moj Parti e bukura!»

Unë shpesh të ngatërrroja me lule behari
ndaj para teje më skuqet fytyra,
se si poet s'dita, të gjeja i pari
kështu siç ndrin plot ngjyra:
«Moj Parti e bukura,
lum ky popull që të ka!»

DAULLJA E FESTIVALIT

Mbase është bërë me cipën e diellit
që vallet tona janë kaq të ngrohta,
mbase është bërë me cipën e detit
që vallet rriten si dallgë nga shqota.

Mbase është bërë me cipën e borës
që vallen e heqin kaq shtruar nuset
dhe më ngajnjë në valle gishtat e malësore
sikur shkundin dëborën nga supet.

Mbase është bërë me cipën e hënës
që ia muarrën natës gjyshërit e dikurshëm
t'ua bënin vello grave,
po u desh pastaj për daulle lufte.

Unë nuk di në u bë prej dielli,
prej hëne apo nga dëbora në male,
po di se një daulle kemi
edhe për luftë edhe për valle.

GJITHMONË USHTARË

(Ushtarëve që prisnin lirimin e radhës)

Ju përshëndes, o vëllezër, sot
në çastin tonë të ndarjes.

Ju ngriheni nga fronti dhë shkoni në front,
gjithnjë së bashku do të jemi ushtarë.

Se në atë muzikë të madhe pune
tek shushurijnë grunjat e verdha,
në sirena...

dhe në buzën e fyellit ku dridhen aq lule
është brenda buria e rreshtave të gjelbra.

Dhe kur dikush do të na çojë kartolinat
nga kantieri...

dhe me avujt e bardhë të ugareve,
ne do të themi:

«Ja miqësi e trimave,
miqësi e kalitur nën tingujt e alarmeve!»

KËNGË, GRURË, DRITË

Kur yjet rrallojnë buzë mëngjezit,
ata në fshatra drita ndezin
e tinguj kënge përzier me farë
mbjellin brazdave në ugar.
«E tunde, moj parti, e tunde,
yjet e bukura nga qielli shkunde»
...Dhe brazdat veç grurit, këngës brënda
kanë dhe yjet që shkundi kënga.

KARVAN YJESH NË DITË ELEKTRIFIKIMI

Në faqe të malit plot dritë
e kuqe, e murrmë duket mjegulla,
diku e kuqe si flakë që përzhit,
diku si tym kanunesh të djegura.

Era mjegullën shtyn, shpërndan
(tërë dritat sikur vihen në vrap) . . .
Për ku është nisur vallë ky karvan?
Karvani i yjeve kërkon tjetër fshat . . .

BLERIMET E MARSIT

Dimri iku me dherat e gërryera...
Ja, tani varen mbi ahishte
retë si lëkura e një ariu të thinjur.
Po vjen pranvera...
Brënda sytheve ka lule dhe filiza,
buzët e kuqe miturake të luleve
do të puthin gjithë njerëzit e bustet.
...Unë ndjej ardhjen dhe rritjen e pranverës
siç ndjen rritjen e fëmijës gruaja,
siç ndjen gëzimin brënda vetes.

P A R T I S Ē

Sikur njëqind herë të bija për ty,
prapë do të ngrihem njëqind herë
të derdh sërish nga gjaku im.
nga djersa ime nëpër veprat e tua...
dhe do të bëhem kaq i pavdekshëm
sa të thinjet dhe guri i varrit tim
duke më pritur mua.

FILLIMI I NJË KËNGE PËR TEPELENËN

Këtu fryn përjetësish një erë e fortë
me këngë luftrash, flamuj dhe lule të kuqe.
Ti mbete betejave gjersa t'u rrudhën gurët nga
dhimbja lugjeve.

Burrat qëndronin në luftë si rrepet,
nënat shkonin në luftë me burrat
Frynte kjo erë dhe tundëte djepet,
frynt kjo erë dhe të fshin rudhat...

D E T I

TURPI I BALALAJKÄVE

Si ju erdhi, o balalajka,
që shkuat në Shtëpinë e Bardhë,
si ju erdhi që pritët duartrokutje
nga duart e gjakosura në Vietnam,
si ju erdhi që u bëtë qejfin barkfryrëve në
Uashington,

si?

Përse, o balalajka, s'i shkulni telat
(fytin e këngëve të pandera),
ç'gjë të bardhë kënduat në Shtëpinë e Bardhë,
si s'u veshën me të zeza beriozat nga ky turp?
Rrugës tek shkonit më mirë t'u kish tharë
morozi¹⁾ i ashpër rus!

1) morozi = ngrica

VËLLAI IM MURATOR

«Mbrëmë — tha vëllai — e mbaruam këtë pallat». Dikush sot ka vënë një vazo në dritare, shoh lulet e kuqe tek muri që varen; përfytyroj gjurmët e gishtave të vëllait, gjurmët e mollzave qënkan bërë petale.

Dhe vështroj vëllanë, e vështroj
sikur s'e kam parë ndonjëherë kurrë
(kqyr duart e tij).
Nëpër duar ka gdhështra gurësh
dhe gurëve është ngjitur njomështia...

Duart e tua gjithë kallo, vëlla,
vija-vija, plasa-plasa,
në duart e tua dhe në duart e klasës
skicuar arkitektura e ditëve të ra.

PORTRRET VJESHTË

Eh, flokverdha vjeshtë,
moj vjeshtë,
Ç'i bëre flokët e tu të verdhë?..
Buzë liqejeve e rrugëve të kanë rënë.
Vilet e pjekura të rrushit në vreshtë
na i shpërndave si një gëzim të ëmbël
...Dhe të kanë hije këto baltra,
këto brazda nëpër ugarë
janë rrudhat me djersë në ballin tënd.

Dhe mua të verdhat flokë po më bien,
balli do t'më mbushet plot rrudha të thella,
dhe si ti, moj vjeshtë, si ti dua të jem,
brazdat në ballë t'i kem plot të mbjella.

SHQETËSIM I BARDHË

Ndërsa mendoja për poezinë,
kumbulla u mbush mje lule të bardha,
çelën portokallet,
çelën kajsitë.

Deti rrahu krahët te brigjet si pëllumb i bardhë
dhe hyri në zérin tim.
Ç'është ky shqetësim kaq i bardhë?!
Ç'është ky shqetësim kaq i mirë?!

Ndërsa mendoja për poezinë,
mali u mbush me dëborën e zambakëve,
vajzat u rritën e u bënë nuse.
Ç'është ky shqetësim kaq i bardhë?!
Ç'është ky shqetësim kaq i bukur?!

Ndërsa mendoja për poezinë,
pranverat e atdheut tim përpara
të gjitha ma bëjnë me dorë.
Në sy më lulëzuan petale
(nën degëzat e rrudhave në ballë).
C'është ky shqetësim kaq pranveror?!
C'është ky shqetësim kaq i bardhë?!



KËNGA ARBËRESHE

Teksa arbët përtej detit i knin
e shanin «Ah qeni turk, pa vatër pse na le!»,
si çupë e bukur nga dhimbja lindi
«O e bukura mëdhe!»

S'e mbytën dot shekujt që erdhën,
i bëri ballë kënga çdo dallge,
në brigjet tona në rivierë
del e hijshme si shtojzovalle

me sy të kaltër si vala,
ballin dhe flokët me stërkala, —
fryma e saj çel portokallen e re
«O e bukura mëdhe!».

Peisazhi ynë ndërron përhera,
oxhaqe... dhe grurë rriten tek ne,
gjithnjë bijëza e Atdheut del tek Riviera
«O e bukura mëdhe!».

DE RADËS

Ndaj perëndimit nëpër gishtat e drurëve mesdhetarë
rrodhën ngjyra të kuqe, manushaqe, të verdha,
nëpër gishtat e tu të dridhur, De Radë,
kulloj qumështi i bardhë i kangjelave

...Dhe e mbylle ti të jetës tënde kapakun,
e mbylle, por sytë këndej të mbetën nga meraku;
«Lisa bota ndrroi» dhe ditë e re kaltëron tek Arbëri,
më e bukur se ç'ta kërkoi ty zemra,
o çobani i kangjelave në fshatin Maki.

BALLADA E BALIL NESHËS¹⁾

Imazh i dridhshëm, i ndritshëm,
kaq dritë dhe kaq dhimbje pranë...
«Topçinjtë me top ta dhanë,
flaka të mori fustanë».

Kur të digjej fustanella
ç'mendoje në atë rrëbesh?
— Lule të bardha të verdha
mbirë në Kurvelesh...

Kur të digjej trupi i bukur
vallë ç'i bëre lotët?

1) Balil Nesha, luftëtar kurveleshas; bashkëkohës i Tafil Buzit e Zenel Gjolekës.

— Porsi yje të këputur
i derdha për shokët...

Për lirinë dhe shokët lule,
që s'u zinte baltë gjuri,
u hodhe dhe flakë lufte
të mbështollën si flamuri.

Zogjt e qëndisur në gjoks
të këndoja një tek flamuri,
Balil-fermele me zogj
Balil-o, Balil nuri...

—
—

—
—

MARKO BOÇARIT

Seç i rrjedh rrëkezë e gjakut
mu tek balli që s'e uli
Marko Boçarit, bajrakut...
Ra një yll nga shkëmbi i Sulit.

Ra një yll nga malet tonë
i madh siç e kishte zënë,
te koka i rri shqiponja,
te këmbët një gjysmë hënë.

Varri me barut i ngjeshur
asnë pikë loti s'qas,
hedhur rrënjet te baruti,
mbrëmjeve ndizet një flakë.

Marko-gjëmim i paprerë,
ndezur vetëtimë e kuqe,
flakë e dredhur fustanellë
të thërret për valle lufte.

Qysh e tund' dheun e rëndë
si tallaganin kur vije,
tundet varri yt ndër këngë
porsi djepë trimërie.

Kitare e armën nën krye
(motra hareje dhe lufte),
hedhur krahët tek të dyja,
lulja e ballit e kuqe.

Seç të rrjedh rrëkezë e gjakut,
ia dëgjoj zhurmimin valës,
n'atë trëndafil tek balli
nisin telat e kitares.

«Dridhjani telat kitares, —
u the shokëve tek të mbanin, —
gjakun përhapur Elladës
prap ma mblidhni për vatanin.

Ngrihu, gjaku ynë, ngrihu,
m'u bëj lule e atij vendi:
tek udhët e Skënderbeut,
tek m'u hodhë vajzat nga shkëmbi.

Kur do shkrepë liria — ylli
mbledhur me çika stërralli,
të më lulëzojë tek syri,
bari të rritet te varri».

* * *

...Frym këndeje mëngjes i bardhë,
çelin mollët te kështjellat,
sikur shokët ngrihen prapë
edhe dredhin fustanellat.

Dil, Marko, se të thërresin:
«Hapi valle të na vejë»,
u ngrit gjaku ynë i ndezur
ndrin një yll-o tejpërtej.

BALLADA E ÇOBANIT

Nëntë hije rrëth e rrotull
përgjonin çobanin.
Shante beu: «dhe ky i poshtër
të ma rrihte djalin»
...Thikë e qenve prapa shpinës
ç'e goditi trimin,
qanin delet kokë më kokë,
plagët i lëpinin.
Foshnjë e vogël e çobanit
fill me nënën mbeti,
ndaj të gdhirë, kur pa llahtarën,
dridhej porsi gjethi.

Qante çobanka çobanin
«Vetullziu im...»
tek shtrunga ia hapi varrin
të dëgjonte blegërimë.

Dhe delet ia ruajtën barin
shark të blertë tek varri,
tek ra loti i çobankës
mbiu trëndelinë mali.

Një ditë foshnja u bë burrë
shkoi me partizanët,
Beun ballist vuri në plumb, . .
në plumb zagarët.

Štimada reviga e sib

nimai e lremal bosc

Kasq si neqipu u sib

Šiu ūtg di sibkosa bisv

Allos si tħallix nsejja ni sib

Šiu ūtg ġej nsejja bisv

MOTIV I SHKUAR

Zogu im kurbetli
edhe i mallēngjyer —
moll' e kuqe ngjyer,
Më ike larg, më fluturove,
udhët e tua më dridhen nē zemér,
më ngjethin.

Çdo miēngjez, nga pritje tē lodhura,
më tē thinjura gdhieni u dhët.

Kur do tē ktheħesh?

Më je larg, pértej deteve.

Ç'tē tē dërgoj, kurbetliu im,
ç'tē tē përcjell?

Tē dërgoj mollë?

Kalben.

Limonët treten.

Tē dërgoj lotët e mi

nē një shami tē hollë?

Lotët e mi janë tē nxehħet

dhe e ngjyen shaminë.
Pesë lumenj e lanin
dhe u ngjyen të pestë.
Vajti thëllëza të pijë ujë
dhe iu ngjyen krahët të zezës.
Vajti zogu të pijë ujë
dhe ndërroi zërin e tij
(dhe më fluturoi hapsirave të shpirtit
zogu i ngashërimit)
...Lumenjtë s'e lanin dot shaminë,
shamija e lotëve m'u bë lëndinë
...Ç'të të dërgojë, zogu im,
ç'të të përcjell?
Deri aty veç lotët vijnë,
detet s'ua presin udhën dot,
ah detet... kanë frikë se mbyten në lotë.

MOTIV DASME

(Muzikë i cikloM)

Ç'u mbush mali plot me rrush
dhe erdhi në dasmën tënde,
ç'u mbush fusha plot me lule,
vajti në dasmën e dhëndërit.

Në pasqyrë stolisej nusja —
lulebrengë, lulejetë;
pasqyra rrëfente dallgë,
pasqyra rrëfehej det.

Derdhte nusja lotë të bardhë,
loti bëhej flutur;
i thanë nënët: «Udhë e mbarë!
Bëfshi shumë fëmijë të bukur!»

ÇIFTI I VARFËR

(*Motiv i shkuar*)

Vajza s'kish me se t'i bënte unazën djalit,
djali s'kish me se t'i bënte fustanin vajzës.
Për fustan ai grisi muzgjet ngjyrë jargavani.
Tej doli hëna si gur i kuq i unazës
(rrethi i hollë i hënës ra nëpër gishtat e barit).
...Ata bridhnin tutje nëpër lirishta
me muzgje të bukura dhe hënën në gishta.

MOTIV NGA FÊMINIA IME

Ca plakave u mbeti në gojë ai çobani
 (isha fëmijë dhe «s'i kuptoja»).
 Ato bënин fjälë për çështje «nderi»:
 «Kush e di, . . . vajzën që e puthi jarani
 vëllezërët ose babai vetë e theri».

PEISAZH MËNGJEZOR

Nga qerpikët e yjeve të vagëlluar
ra vesa mbi barin fije-fije
dhe bari i porsamungulluar
u drodh si telat e një violie.

Tingujt e dridhshëm sikur botën grishën,
zogj të bardhë fluturuan mbi kavakët¹⁾,
nusja e re kopsiti këmishën...
dhe gjyshi lau sytë me ujë të kaltër

Kaq herët po të mos isha ngritur
askurrë nuk do ta dija
se edhe nën tingujt e barit flladitës
rrëmbimthi u hedhka gjithësia.

1) Kavakët — plepat

DASHURI E BUKË PËRQAFOVA

Po korrej gruri kur shkova në fshat,
fusha zjente nga kënga e të rinjve;
sykaltra ime s'më priti me lule,
sykaltra mbante tufat e kallinjve.

Dhe zbrita unë atje i malluar,
ledhit pranë saj qëndrova...
Sykaltrës kallinjtë i mbetën në duar
sykaltrën, kallinjtë i përqafova.

KTHEHEMI NË RIVIERËN E AKSIONIT

Sa shpejt na u rritën portokajt, Vala,
dhe për mirseardhje na lulëzojnë limonët.
.. Nën yje të kuqe — lule të bardha
(një rivierë me yje dhe lule ëndërronim).

Dhe ëndrrat na çelen nëpër dega,
dhe këngët na mbetën nëpër erë portokalli...
Vala e detit mbulon barin me dantella,
tek rrnim dikur është rritur bari.

Eja të lozim portokajve të bukur
si kjo hënë e re mes reve me kaçurrela të verdha,
eja tek «vendi ynë» dhe ulemi...
Dhe vala mbulon barin me dantella...

, : : DHE VALLET

Udhët e valles i kemi të bardha, të mira,
lidhur në dyfek e lidhur në kaba;
vajzat zunë duart, u bënë trëndafila,
djemtë ranë në valle, u ngritën kala.

Erdhën nga TEC-i dhe hekurudha,
tund shamtë si shkumë të bardha Fierza, —
siç ngritëm kala me malet e bukura,
dhe vallet që hedhim na bëhen kështjella.

FRYN ERË E VENDLINDJES

Frymë e vendlindjes
ulli më ulli,
seç m'i hapi vargjet,
hyn në poezi.
Ç'këndon fushë e grurit
o halë më halë,
mia mbush poezinë
plot me bukë të bardhë.
Frymë e vendlindjes
në çdo vrimë curle,
ç'kundërmojnë këngët,
ç'kanë aq shumë lule.
Dhe përmbi aroma
kundërmon me erë
nëpër këngët tonat:
«Lule, o Enver!»
Frymë,
vjen frymë e nënës —

shushurimë plepi,
vjen: «M'u bëfsh ushtar!»
kënga që nga djepi.
Frym erë e vendlindjes,
tufëzat mbi bar,
gjelbërimi i saj
më veshi ushtar.
Këputi burbuqen
mbirë në lëndinë,
ma vuri në ballë
yll përmbi bustinë.
Frym erë e vendlindjes,
ngrihem në alarme,
mos trazohen mollët
dhe lulebajamjet;
mos trazojnë këngët
armiqtë ku janë,
mos na vrasin ëndërrat
e fëmijëve tanë.

L I R I A

Me gjakun tonë e rritëm
në shekuj,
e ngrohëm lirinë si lule nën brymë.
Veç malet na e dinë se ç'gjak kemi derdhur,
se maleve ballët ua ndriti gjaku ynë.

...As fjalët: nëna, biri e bija
s'e kanë dot atë lidhje gjaku
sa shqiptari, malet dhe
liria
që lulëzon e kuqe si zambaku.

BLERIMI I LULEVE NËPËR KËNGËT POPULLORE

Ç'ish ajo stinë, vallë, ç'ish ajo stinë
që në shpirt të popullit aq lule të bukura mbinë
dhe mes plagëve këndoi ai me zemër luani
«Lule, Sofo, lule xhani,
lule, Sofo partizani»!?

Ish stinë me lule, ish stinë me plagë,
nëpër këngë mbinë lule që s'ishin parë
dhe blerimi i këngës emrat e tyre fëshfërithi:
«Lule, Sofo, lule shpirti,
lule, Sofo komunisti».

TE RËNÈVE

*“Lule more trima
që ratë për atdhe”*

Ratë në gjirin e tokës nënë
armikun dhe vdekjen duke e përqmuar.
ratë e kjo tokë u bë më e rëndë
siç është i rëndë metali i çmuar.

Ratë e në zemra na u bëtë të shtrenjtë...
Ratë me një dyfek, me një pagure,
ratë... mbi tela dhe u bëtë këngë,
ratë në këngë dhe mbetët lule.

PARTIZANI ME DYJARE

Na e vranë nazistët partizanin me dyjare,
na e vranë tek i binte curlës me aq ëndje;
ne pushonim pas aksionit nën hijen e një arre,
ai thurte melodi për aksionin atë mbrëmje.

Oh, q'na e vranë shokun tonë Hysa.
Ne ia vendosëm mu pranë buzëve dyjaren.
Nëpër vrimat e dyjares çelën sytha,
mbinë lastarë e lule këmbore zbardhën.

Dhe nga fryma e tij gjithnjë e ngrohtë
frym kjo erë e fëshférinjtë ndaj të ngrysur,
nëpër degët e bardha me lule plot,
lulet vazhdojnë këngën e lënë përgjysëm.

DUKE NDJERË IMAZHIN E BARDHË TË DËBORËS

Gjithkund zbardhon dëbora e prerë:
mbi lirishta... mbi varrezat e atyre që ranë,
po sikur e tëra të jetë mermer,
s'del dot për bustet e heronjve tanë.

...dhe prapë s'do të mjaftonte kjo borë
sikur të ish mëndafsh mbi livadhe
t'ia prisin lumturisë fustan nusëror,
se lumturia jonë është aq e madhe.

... DHE S'DI SE Ç'YLL I RA NË FAQE

(*Vegim nga fëminia*)

Ja, ky është fshati i vllehëve
ndërtuar i bukur në një faqe,
nga kodra zbret një vajzë brigadiere
me bluzë pambuku ngjyrë manushaqe.

Eh, ç'më kujtojnë këto manushaqe, brigadiere,
në fshatin tim, kur mbanin tufat,
përditë u shkoja në kasolla vllehëve
e lozja atje me Ristën e bukur.

Sa shumë e doja Ristën sylar me
dhe kur babai i largohej me dhentë,
i thoshja: «Ty Ristë unë të kam nuse»
po ajo më thosh: «Do të lëshoj qentë».

Një ditë zabelit, larguar prej stanit,
tek lule manushaqesh këpuste
unë e kapa për jakën e fustanit
e i thash: «Tani ty Rista të kam nuse!»

E loza më të nëpër dëllinja.

Ia mora lulet

...dhe s'di seç yll i ra në faqe
u skuq... e çirrej si mëllenja:
«M'i jep, m'i jep ti manushaqet!»

Hej, sa më trëmbi zëri i të atit kur thirri:

«C'ke moj Ristë që cirresh e bërtet?!»

Manushaqet më ranë e u përndanë tek burimi
E Ristën vetëm e lashë në zabel.

E s'di nga vajti që atëhere
vllahja e bukur që u nda nga unë,
ti ndoshta je vetë, moj brigadiere,
se sytë të ngjajnë me të aq shumë.

Jani ldn. vj. Jani or. 174. 200
174. 200. 174. 200. 174. 200.
174. 200. 174. 200. 174. 200.
174. 200. 174. 200. 174. 200.
174. 200. 174. 200. 174. 200.

H E N A

Sa herë që del ti përmbi mal
unë pëshpëris me vete «Hëna»
dhe shoqja e klasës me emrin tënd
kështu për herë s'më del nga mendja.

Sa hyn mes kopshtit të bardhë tek shtegu
dhe të fëshfërijnë përreth lule qershie,
unë kujtoj se ajo është veshur
në rroba të bardha nusërie.

Kur ndodhen ndaj teje retë grigja-grigja
dhe ti nga sipër rreze u derdh,
tufat e reve të lara me dritë
më ngjajnë me flokët e saj të verdhë.

Dhe prapë tani ty përmbi mal
të shoh si m'i ke hedhur flokët,
rrezet me dritë luginave zgjaten
si rrugë të mira për tek shokët.

O MOJ SHQIPËRI E BARDHË

...Edhe nuset të bardha,
edhe malet të bardha,
edhejeta e bardhë.
Për trimat që ranë
mbështetur kryet gurëve,
këtu gjithçka do të jetë e bardhë
veç gjakut dhe flamurëve.

DASHURIA JONË

*Moj leshverdha dega-dega
si palla që mban Gjoleka*

Populli

S'besoj në botë një popull tjetër
t'i ketë këngët si të timit
ta kërkøjë të bukur leshverdhën
dhe në pallën e lavdishme të trimit!

Mund që bota të thonë vërdallë:
«Janë pa shije, vajza është flutur,
E ku krahasohet femra me pallë?
Si qënka palla si femrat, e bukur?

Në thënçin kështu, do të qeshë me të madhe
ky populli im, i miri,

kush tjetër veç dashurisë dhe armëve krenare
na i ruajti lulet tek çairi!

...Veç, kujt i ndriti palla prej dore
e grisi me të armiq sa ju derdhën,
veç ai ia njeh bukurinë madhështore,
si palla, të bukur, e do leshverdhën.

Shtëpi evërtës ofis shtetit të vjet të
Lindjeve të shqiptarëve

etob jenq qëllq lirku i tijt do...
në qytetin e tijt qëndron në qytetin e

SHTËPIA E DYFEQEVE

(Poemtë)

Shtëpia këtu kundërmon bukë e trëndafil
se fryn fusha dhe na sjell kallinj,
se fryn mali me erë të mirë...

Kjo shtëpi mund të ketë qënë me një tra,
siç këndonte fukarai popull për vete,
po në rrebescheshet e luftrave ngrivej kala
se e mbanin të fortë tytat e dyfeqeve.

Trualli këtu është i pjerrët, bokërrimë
dhe zor të qëndrojë pa qenë i fortë,
po pesha e armëve që mbanin shtëpinë
muret më thellë i ngulte në tokë

Këto mure varën armët e gjyshërve,
gjyshërit na u thinxën nga luftrat e gjata,
ballin të rrudhur e të ngrysur
vetullat të bardha e të rënda si shpatat.

Arimiq të egër na u sulën nga çdo anë
na erdhën hordhi me harem e daulle,
po të paepurve, gjyshërve tanë,
shpata tek e mbanin u lëshonte lule.

S'u lodhën nga luftrat gjer në vdekje
dhe këngë lufte ikën përmes të shtënavë,
lule shpatash shkunden mbi djepe, —
kështu të rriteshin djemtë e nënave.

Nënët me atë drítë të butë si hëna
kur lindnin bijtë mes grurit tek ara,
në ninulla u varnin armë të rënda
që të mos nxuhej nën këmbë lulebardha.

Dhe... për liri

gjaku i bijve u poq
e na mbushej shtëpia me djem komita,
vinte Balili — Fermele me zogj,
Janaq Kumiu me shtatë drita.

Vinte Gjoleka nga Grykë e Kuçit
(fustanella «mbi gju hajduçe»)
dhe pranë shpatave në faqet e murit
vareshin dyfeqet «me nëntë strufe».

Ne këtu brez pas brezi varëm
jatagan, dogra... e martina,
na zbardhi faqen dyfeku me gjalmë
kur ramë mbi Vlorë si vetëtima.

Me atë dyfek me gjalëm në dorë
nëpër krisma, flakë jeshile e mjegulla
u hodhëm mbi topa e prozhektorë
dhe pritëm me gjokse zjarr e predha

Nga gjokset tona të forta prej stralli
gjaku ynë i ndershëm lëshonte çika
(ç'dritë!)

dhe s'kish ku futej italianni
se gjaku ish më i fortë se «alitrika».

Djemtë tanë... (u çudit bota)
kurrë nuk thanë «na u prish bukuria»,
po me nofull copa-copa
thanë: «Të rrojë Shqipëria!»

Deti u thinj kur i pa tek binin,
trendelina u skuq nga dhimbja e madhe,
po Shqipëria kurrë nuk mibeti pa trima
siç nuk mbetën pa lule këto male.

... Fryu një erë dhe na çelën yje;
nën yje... partizanë mbi shkrepë
«Dritë për lirinë», tha Partia
dhe nisi marshi i yjeve në çeta.

Dyert hapur i priti shtëpia
nëpër llohë, rrebesch e kohë të keqe,
u thau rrobat e qullura nga stuhia,
u ndezi zjarr, u mbështeti dyfeqet.

Na erdhi Enveri — mal me yje
me djem e vajza — shqiponja me nure
dhe kur na puthi ballin neve fëmijëve
...buza e qeshur një degëz me lule.

Nën atë dritë të bukur, të bardhë
Shqipërisë do t'i ndritnin udhët qelqe,
«O burra!» — na kërkoi liria burra sa më parë
dhe u rritëm me nxitim e hodhëm dyfeqe.

Dhe kur na vritej vëllai kaq i ri
(shtatë vrima plumbash në gjoks)
mbushej fyelli me këngë e elegji
kur e puthnin në buzë motrat dhe shokët.

Ç'gjak i bukur na derdhej në hendeqe
dhe përzinim armiqjtë e egër bishë;
lirisë ia pastronim rrugën me dyfjeqe
dhe e pritëm me lule nën këmishë.

O si zbardhi mali — ballë i prerë me drithë.
nën mëngjeset që erdhën, Shqipëri sërmaja
.... Një nënë këput trëndafila për bijtë
e presin djemtë prej mermeri tek pllaja.

Ajo kish dy djem të bukur si yje,
ajo kish shumë bijë me yje në male,
e merr malli dhe puth mermjet e bardhë.
e merr malli dhe puth maliheret e tyre.

Kështu na puthin nënët dhe armën.
Mbrëmë...
erdhi fotografia e djalit ushtar:

Nëna puthi djalin

dhe karabinë bajonetbardhën
(i vendosi pranë shpatës dhe dyfekut me gjalëm).

Në mur dyfeku që dëgjoi botë,
shpata nur-zambaku mbi dyfek
dhe të dy bashkë në duart tonë
rëndojnë në një pushkë me bajonetë.

Këto pushkë i mbajmë tek hidrocentrali...
Këto pushkë i mbajmë tek delet (nën sherqe)¹
kur kthehemë në mbrëmje pranë dritave i vërim
tek ti shtëpi e dyfeqeve.

Motrat tonë kur kthehen prej fushës
(seç vajza — rritur furtunë e ylber)
ato në mure varin pushkët
dhe nëpër tyta kallinj të verdhë.

Kështu i vendosnim gjithnjë tek shtëpia
armët pranë grurit me gjak përvsesur

1) Sherqe — shumësi i fjalës shark.

që si gruri të frynte e bukur liria
se armët
për lirinë dhe grurin janë përleshur.

Se për grurin ngriheshin nëpër natë
e numëronin një nga një kallinjtë
se do të rritnin djemtë për shpatë,
se do të bëheshin për dyfjeqe bijtë.

Sot bijve tanë u buzqesh pranvera,
ata — lulëzimi ynë i ëndrrave dhe gjakut
Ja, mbesë e vogël....
pranë shtëpisë së dyfjeve
tek dera

më loz me një pushkë druri me gjalëm.

Unë i flas, ajo vazhdon të lozë....
Nga zëri i saj mbushen drurët me fletë
dhe pushka e drunjtë bën të hyjë tek shtëpia,
të kthehet në pushkë të vërtetë...

PASQYRA E LËNDËS

Faqe

| | |
|--|----|
| Bukuria | 3 |
| Daullja e festivalit | 4 |
| Gjithmonë ushtarë | 6 |
| ...Këngë, grurë, dritë | 7 |
| Karvan yjesh në ditë elektrifikimi | 8 |
| Blerimet e marsit | 9 |
| Partisë | 10 |
| Fillim i një kënge për Tepelenën | 11 |
| Deti | 12 |
| Turpi i balalajkave | 13 |
| Vëllai im murator | 14 |
| Portret vjeshte | 15 |
| Shqetësim i bardhë | 16 |
| Kënga arbëreshe | 18 |
| De Radës | 19 |
| Ballada e Balil Neshës | 20 |
| Ballada e Balil Neshës | 22 |
| Marko Boçarit | 25 |
| Ballada e çobanit | 27 |
| Motiv i shkuar | 29 |
| Motiv dasme | 30 |
| Cifti i varfër | 31 |
| Motiv nga fëminia ime | 32 |
| Peisazh mëngjedor | 33 |
| Dashuri e bukë përqafova | 34 |
| Kthehemë në Rivierën e aksionit | 34 |

Faqe

| | |
|---|----|
| ...Dhe vallet | 35 |
| Frym erë e vendlindjes | 36 |
| Liria | 38 |
| Blerimi i luleve nëpër këngët popullore | 39 |
| Të rënëve | 40 |
| Partizani me dyjare | 41 |
| Duke ndjerë imazhin e bardhë të dëborës | 42 |
| Dhe s'di se ç'yll i ra në faqe | 43 |
| Hëna | 45 |
| O moj Shqipëri e bardhë | 47 |
| Dashuria jonë | 48 |
| Shtëpia e dyfjeve (poemth) | 50 |

Tirazhi 1500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1975